



PRANUAR MË:  
ACCEPTED ON: 10/01/2023  
PRIMLJENC:  
Nr. Nr. D: 08/02



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KOMUNA E MALISHEVËS**  
**Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural**



Nr. 08/\_\_\_\_\_

Malishevë më: 10.01.2023

Duke u bazë në vendimin e datës 24.10.2022, nr. 02/501, të Kuvendit Komunal të Komunës së Malishevës, Pëlqimin e datës 05.02.2009, nr. Ref. 01/20/09, nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në dispozitat e neneve, 27, 34 dhe 35, të Ligjit për Gjueti, Nr.02-L/53, Udhëzimin Administrativ, Nr. 06/2009 për dhënien në Menaxhim të Vendgjuetive të Përbashkëta, si dhe në bazë të Aktvendimit të Kryetarit të Komunës me nr. 01/2136 të datës 27.12.2022, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, shpall:

## **OFERTË PUBLIKE**

Për dhënien në menaxhim të vend-gjuetive të përbashkëta:

”**Malisheva 1**”, me sipërfaqe të përgjithshme prej 16,241.05 ha dhe sipërfaqja ku do të zhvillohen aktivitetet e gjuetisë është 1,505.01 ha; dhe

”**Malisheva 2**”, me sipërfaqe të përgjithshme prej 14,344.29 ha dhe sipërfaqja ku do të zhvillohen aktivitetet e gjuetisë është 13,327.92 ha.

Sipërfaqja e përgjithshme e dy vend-gjuetive të përbashkëta është: 30,585.34 ha, ndërsa ajo e ku do të zhvillohen aktivitetet e gjuetisë është: 14,832.93 ha.

### **Rëndësia e vendgjuetive së përbashkëta**

Rëndësia e dhënies me qira të vendgjuetive të përbashkëta ka për qëllim që të rregullohet menaxhimi i qëndrueshëm, kultivimi, mbrojtja, gjuetia dhe shfrytëzimi i faunës së egër si pasuri natyrore me interes të përgjithëshëm të cilat gëzojnë mbrojtje të veçantë.

## **Kushtet e përcaktuara për ofertuesit sipas dispozitës së nenit 5 të Udhëzimit**

### **Administrativ Nr.06/2009, janë:**

1. Dëshmia e regjistrimit të veprimtarisë;
2. Dëshmi mbi përvojën e punës në menaxhimin me kafshë të egra dhe gjueti (kjo vlen për menaxhuesit e gjertanishëm me gjueti — shoqatat e gjuetisë) nga Federata e Gjahtarëve të Kosovës, si dhe përshkrimin e rezultateve menaxhuese nga vitet paraprake;
3. Dëshmi mbi përvojën e punës në menaxhim dhe rezultatet e arritura në veprimtari të ngjashme - për subjektet tjera juridike dhe fizike si në: pylltari, bujqësi, veterinë, turizëm, ekologji;
4. Dëshmi për shërbimin profesional që do të angazhohet në menaxhim, duke përfshirë numrin e të punësuarve, gjuetarë të kualifikuar, roje gjuetie të certifikuar. profesionistë të florës dhe faunës;
5. Programin për synimet e menaxhimit dhe zhvillimit të vendgjuetisë - mbrojtja, ruajtja, kultivimi dhe shtimi i kafshëve të egra;
6. Dëshmi nga gjykata se personi përgjegjës nuk është i dënuar ose i ndjekur për vepër penale;
7. Dëshmi që vërteton se nuk ka obligime financiare ndaj Agjencisë Tatimore të Kosovës;
8. Dëshmi për posedimin e mjaftueshëm të mjeteve financiare për ushtrimin e kësaj veprimtarie;
9. Çmimi më i lartë i ofertës për qira.

## **KRITERET PËR DHËNIEN E OFERTËS**

Oferta e cila i plotëson kushtet e specifikuar dhe ka çmimin më të lartë ofertues për qiranë do të shpallet fitues i këtij projekti.

Të drejtë aplikimi sipas dispozitës së nenit 34, të Ligjit për Gjuetinë, Nr. 02/L-53, kanë personat fizik dhe juridik që i plotësojnë kushtet e përcaktuara me UA Nr. 06/2009,

**Afati i shpalljes publike nga 10.01.2023 deri më 23.01.2023 në ora 13.00.**

Materiali ofertues tërhiqet në Zyrën e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në objektin e Komunës së Malishevës, kati i dytë.

Oferta duhet të vendoset në pliko të mbyllur dhe të jetë e vulosur nga ana e ofertuesit.

Dorëzimi dhe protokolimi i ofertave nga ofertuesit bëhet në zyrën e pritjes në objektin e Komunës kati i parë.

**Hapja e ofertave bëhet me datë 23.01.2023 në ora 14:00, në sallën e kuvendit Komunal, kati i dytë, në objektin e Komunës së Malishevës.**

Tabela1: Specifikimi i çmimit fillestar për Vendgjuetinë “Malisheva 1” dhe “Malisheva 2”

NR.	Lloji i kafshëve, shpezëve të egra	Numri i kafshëve, shpezëve të egra në copë	Çmimi për copë	Shuma €
1	Derri i egër (sus scrofa)	9	80	720.00
2	Lepuri i zakonshëm (lepus europeus)	26	25	650.00
3	Dhelpra (vulpes vulpes)	7	100	700.00
4	Fëllënza e fushës (perdix perdix L)	32	15	480.00
5	Turtullesha (streptopelia turtur)	16	10	160.00
6	Pëllumbi gungash (colimba palumbus)	26	10	260.00
<b>Kafshët e egra të rralla dhe të rrezikuara dhe përher të mbrojtura</b>				
7	Kaprrroll	0		
8	Dhi e egër	0		
9	Ari	4		
10	Ujk	6		
11	Korbi	33		
12	Macë e egër	15		
13	Ketri	21		
14	Gjeraqinë	0		
<b>TOTALI:</b>				<b>2,670.00</b>
<b>Gjithsej: 2,670.00 x 50%</b>				<b>= 1,335.00 €</b>

Çmimi fillestar bazë për shpallje të Ofertës Publike për Vendgjuetinë “Malisheva 1” dhe “Malisheva 2”, sipas Ligjit për Gjuetinë është **1,335.00 €/vit**.

## INFORMATA SHITESË

Dhënia me qira në menaxhim të vendgjuetive të përbashkëta do të jepet në afat kohor prej 10 vitesh (sipas UA, Nr. 06/2009)

Drejtori:  
  
Sylë Dukolli ecc.dip.

